



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 263/ 2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega ne Malishevë dhe ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Malishevë, paraqitur kundër subjektit politik Nisma për Kosovë dega ne Malishevë, për shkak te blerjes së votave gjatë ditës së zgjedhjeve ne qytetin e Malishevës, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014 mori këtë:

V E N D I M

HIDHEN si të palejuar ankesat Anr.263/2014 , Anr.264/2014, Anr.265/2014, dhe Anr.288/2014 të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega ne Malishevë dhe ankesa e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Malishevë

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.06.2014, ka pranuar ankesat Anr.263/2014 , Anr.264/2014, Anr.265/2014, dhe Anr.288/2014 të parashtruara në PZAP nga subjekti politik PDK dhe nga subjekti politik se në qytetin e Malishevës konkretisht në vendvotimin në shkollën fillore “Hamdi Berisha” aktivisti i subjektit politik Nisma për Kosovë Ardian Mazreku profesor i edukatës fizike, bashkë me një grup të militantëve të Nisma për Kosovë, ju kanë ofruar qytetarëve rryshfet për blerjen e votave. Andaj me këtë rast parashtruesit e ankesës theksojn se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 33 pika f) të LZP-së

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak te efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejshmërisë së ankesave gjeti se:

Ankesat janë të palejuara

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi ankesat në fjalë gjeti se për këtë çështje PZAP-i ka vendosur më parë me vendimin e tij Anr. 259/2014 të datës 11.06.2014, të parashtruar me ankesë në PZAP nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kundër subjektit politik Nisma për Kosovë. Andaj meqenëse për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli vendosi që ankesat në fjalë ti hudhë si të palejuara.

PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it ,si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 263/2014 më datën 12.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i,*